

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Për Planin e Integritetit 2026-2028 të Bashkisë Durrës”.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me “Planin e Integritetit 2026-2028 të Bashkisë Durrës”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Durrës në datë **24 Korrik 2026, ora 12:00.**

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë gjithashtu të mirëpritura deri më datë 24 Korrik 2026, në adresat e emailit:

Daniela.Murataj@durres.gov.al

brunilda.gripshi@durres.gov.al

keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës.
- Banorët e Bashkisë Durrës, pjesëmarrës nga Njësitë Administrative të bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.,

Forma e konsultimit: Takim publik dhe postë elektronike.

Qëllimi i këshillimit publik	<p>Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me “Planin e Integritetit 2026-2028 të Bashkisë Durrës”.</p> <p>Plani i Integritetit paraqet një mjet të rëndësishëm për forcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ai është një dokument strategjik dhe operacional, dhe është produkt i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit. Ky plan pason dhe përmirëson përvojën e akumuluar nga Plani i Parë i Integritetit 2021-2024, i cili ishte nisma e parë pilot e bashkisë për menaxhimin e riskut të integritetit në nivel vendor.</p> <p>Plani i Integritetit 2026-2028, si një instrument menaxhimi për parandalimin e korrupsionit u hartua duke u bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të monitorimit të planit të mëparshëm i cili hodhi themelet në drejtim të: krijimit të standardeve etike në institucion; rritjes</p>
------------------------------	--

	<p>së kapaciteteve të burimeve njerëzore; përmirësimin të transparencës dhe llogaridhënies publike, megjithatë gjatë kësaj periudhe u evidentuan edhe kufizime, si mungesa e përditësimit të rregullave me ndryshimet e reja ligjore mbi etikën dhe integritetin, mungesa e një skeme të qëndrueshme monitorimi, si dhe përfshirja e aktorëve të jashtëm.</p> <p>Plani 2026-2028, adreson këto mangësi, duke vendosur një sistem të integruar të menaxhimit të kuadrit ligjor mbi etikën dhe integritetin, si dhe raportimin periodik për realizimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit.</p> <p>Qëllimi i këtij plani është të krijojë dhe konsolidojë një administratë vendore me integritet dhe etikë, transparente, inovative dhe të përgjegjshme për qytetarët, ku Këshilli Bashkiak (KB), administrata dhe shoqëria civile bashkëqeverisin në mënyrë etike, duke krijuar një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit.</p>
Përshkrimi i çështjes.	<p>Plani i Integritetit 2026–2028 është hartuar mbi bazën e kuadrit kombëtar kundër korrupsionit, rekomandimeve të GRECO-s, legjislacionit për qeverisjen vendore dhe metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Procesi u zhvillua nga një grup pune i ngritur në bashki, me mbështetjen e ekspertëve të AMVV-së, dhe përfshiu analizën e dokumentacionit institucional, fokus-grupe me punonjësit, si dhe një pyetësor anonim të plotësuar nga punonjës të administratës. Nëpërmjet këtij procesi u identifikuan, u analizuan dhe u vlerësuan risqet e integritetit sipas probabilitetit, ndikimit dhe efektivitetit të kontrolleve ekzistuese.</p> <p>Bazuar në rezultatet e vlerësimit, Plani përcakton objektiva dhe masa konkrete për forcimin e integritetit institucional, duke u fokusuar në përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator, zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e risqeve në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë. Plani i Veprimit parashikon masa të qarta, afate dhe struktura përgjegjëse, ndërsa zbatimin e tij do të monitorohet në mënyrë periodike për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të integritetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve publike.</p>

<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit më poshtë, brenda datës 24 Korrik 2026. Daniela.Murataj@durres.gov.al brunilda.gripshi@durres.gov.al keshillidurres@gmail.com</p>
<p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.</p>	<p>Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore. https://durres.gov.al/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/</p>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit në bashkëpunim me KNJKP i një “Përmbledhje të rekomandimeve dhe rezultateve të plota” që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti. • Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisioni i Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve dhe Komisionit të Mardhënieve me Jashtë dhe Integritetit Evropian, Koordinatorit të Grupit të Punës i ngritur për hartimin e planit të integritetit me urdhër të Kryetares së bashkisë dhe çdo këshilltari të bashkisë; • Shqyrtimi nga ana e Komisionit të mësipërm të çdo rekomandimi; • Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në “Planin e Integritetit 2026-2028 të Bashkisë Durrës” dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, të Bashkisë Durrës. • Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; • Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; • Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; • Monitorimi i zbatimit të tij.
<p>Data e publikimit</p>	<p>29.06.2026</p>